

PËRDORIMI MË I GJERË I KONTRATAVE FORWARD KËRKON RITJE TË EDUKIMIT FINANCIAR

Credins Bank po përgatitet të ofrojë për klientët e saj marrëveshjet forward të këmbimit valutor. Në një intervistë për “Monitor”, Klodiana Xhepa, Chief Dealer (Përgjegjëse e sektorit të këmbimit valutor) në Credins Bank, thotë se, deri tani, aplikimi i këtyre kontratave në sektorin privat ka qenë i kufizuar, edhe për shkak se ato janë produkte financiare derivative, që kërkojnë njohuri dhe edukim financiar më të zgjeruar.

Cfarë janë marrëveshjet forward të këmbimit valutor? Cilat janë zakonisht afatet maksimale që parashikojnë këto marrëveshje?

Marrëveshjet Forward janë kontrata financiare dypalëshe, ku palët bien dakord që në një datë të caktuar në të ardhmen do të shkëmbejnë një shumë parash ose malli, me një kurs të përcaktuar në ditën e nënshkrimit të kontratës. Ato përdoren kryesisht për t'u mbrojtur nga luhajtje të kursit, ose çmimit, në të ardhmen. Afatet e këtyre kontratave mund të jenë nga 3 ditë deri në 12 muaj. Këto kontrata quhen ndryshe kontrata të së ardhmes. Termat e kontratave forward vendosen vetë midis dy palëve, pa pasur nevojë për ndërmjetës.

A ofrohen aktualisht marrëveshjet forward nga bankat tregtare në Shqipëri dhe cilat mund të jenë avantazhet dhe përfitimet e tyre për palët?

Marrëveshjet forward ofrohen nga disa banka tregtare në Shqipëri, edhe pse si produkt është shumë specifik dhe jo i përhapur në përdorim. Banka Credins është duke përgatitur procedurat e brendshme në mënyrë që t'u ofrojë klientëve mundësinë e përdorimit të kontratave forward, në të ardhmen e afërt. Kontratat forward shërbejnë për t'u mbrojtur nga luhatshmëria e kursit/çmimit në kohë. Kontrata të tilla janë të përdorshme më shumë në llojet e bizneseve, ku luhatshmëria e kursit i ekspozon dhe jep ndikim të ndjeshëm në përfitueshmërinë e biznesit. Njëpërmjet kontratave forward, subjekti përdor këtë kurs të fiksuar në ditën që do t'i duhet, në një të ardhme të përcaktuar, duke iu përmbajtur marrëveshjes së rënë dakord. Në këtë mënyrë, biznesi shmang rrezikun që mund t'i shkaktojnë luhajtja e kursit në procesin e veprimtarisë së



tij. Kontratat forward janë më fleksibël, krahasuar me llojet e tjera të kontratave të së ardhmes (futures), duke qenë se standardet dhe termat e tyre vendosen nga vetë pjesëmarrësit. Nga ana tjetër, kjo lloj marrëveshje mbart dhe riskun për të mos u ekzekutuar, nëse njëra nga palët devijon deri në maturimin e saj. Në të tilla kontrata, shpeshherë palët për të qenë të sigurt në ekzekutimin e marrëveshjes kërkojnë kolateral ose garanci (fonde të ngurtësuar). Respektimi i kushteve të kontratave mund të sjellë edhe rekurse ligjore.

Cilat janë arsytet që deri më sot këto marrëveshje nuk janë shumë të njohura dhe të përdorura nga sektori privat në Shqipëri?

Kontratat forward bëjnë pjesë në produkte financiare derivative, që kanë specifika të veçanta dhe kërkojnë njohuri të zgjeruar për tregjet financiare dhe termat e përdorimit. Zhvillimi dhe aplikimi i këtyre kontratave në sektorin privat ka qenë i kufizuar. Ka pasur një ngërc në aplikimin e këtyre marrëveshjeve nga bankat e nivelit të dytë, si vetë bankat me njëra-tjetrën, po ashtu dhe bankat me klientët e tyre. Kjo

për shkak se Shqipëria ende nuk është pjesë e protokollit të marrëveshjes ISDA-s (modeli ndërkombëtar më i përdorur i kontratës në operacionet e mbrojtjes financiare), mungesë kjo në legjislacion specifik. Gjithashtu, përdorimi i këtyre kontratave kërkon edukim financiar të zgjeruar dhe tashmë përpjekjet në këtë drejtim janë shtuar në tregun vendas nga institucione vendase dhe të huaja.

A ka pasur interes nga bizneset për të përdorur marrëveshje forward gjatë këtij viti, me rritjen e luhatshmërisë në kursin e këmbimit valutor?

Interesi i përdorimit të marrëveshjes forward ka qenë në rritje, për shkak se kursi i këmbimit ka treguar luhatshmëri të lartë gjatë këtij viti dhe duke qenë se këto janë marrëveshje të posaçme të cilat shërbejnë për mbrojtjen nga luhatshmëria në kurs këmbimi. Momentalisht, kemi pasur më shumë pyetje dhe interesim të bizneseve rreth përdorimit të këtyre marrëveshjeve.

Për cilët segmente dhe sektorë të biznesit mund të jenë më të dobishme marrëveshjet forward?

Kontratat forward janë të dobishme për sektorin e fasonerive, hidrokarbureve, si dhe të bizneseve të ndryshme që eksportojnë dhe importojnë mallra. Lidhja e kontratave të tilla u jep mundësi bizneseve të kenë nën kontroll paraprakisht përcaktimin e kostos apo dhe në përlllogaritje përfitueshmërie, duke pasur parasysh një kurs të fiksuar më parë.

Banka e Shqipërisë, në dy vitet e fundit, po aplikon blerje forward në ankandet e saj valutore. A mund të ketë ky mekanizëm një rol në zhvillimin e kontratave forward mes bankave dhe sektorit privat?

Banka e Shqipërisë, një pjesë të ankandëve për blerje valute, po e zhvillon njëpërmjet blerjeve forward. Mendojmë se kjo formë ankandi për blerje valute është bërë me qëllim testimin dhe zhvillimin e këtij produkti midis bankave vendase. Kjo formë e re e ankandëve forward na ka sjellë më afër me praktikat ndërkombëtare dhe na ka ndihmuar që të zhvillohemi në të njëjtin drejtim dhe më tej ta aplikojmë te klientët e bankës. ■

KONVERTO ME KURSET MË TË MIRA NË CREDINS ONLINE.



SDG Business
Pioneers Award
in Albania